

**VENDIM**  
**Nr. 114, datë 17.2.2016**

**PËR KALIMIN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA  
MINISTRIA E MBROJTJES TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE, PËR  
DEGËN E ARKIVIT SHTETËROR VENDOR NË BERAT, TË KATIT TË PARË E TË  
KATIT TË DYTË TË OBJEKTIT NR. 1 DHE OBJEKTIT NR. 2, PJESË TË PRONËS NR.  
1047, ME EMËRTIM “QENDËR MOBILIZIMI”, ME VENDNDODHJE NË BERAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar dhe nenit 901 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, për degën e Arkivit Shtetëror Vendor në Berat, të katit të parë e të katit të dytë të objektit nr. 1, me sipërfaqe 396 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m<sup>2</sup> dhe të objektit nr. 2, me sipërfaqe 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) m<sup>2</sup>, pjesë të pronës nr. 1047, me emërtim “Qendër mobilizimi”, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për administrimin, ruajtjen dhe përpunimin e dokumentacionit të Arkivit Qendror të Shtetit, deri në datën 31.12.2024.

2. Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, degës së Arkivit Shtetëror Vendor në Berat u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e objekteve të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, t’i tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

3. Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të nxjerrin aktet e nevojshme për dhënien në përdorim të objekteve, duke përcaktuar detyrimet për secilin institucion.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, drejtori i Përgjithshëm i Arkivave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

KOMANDNTI  
KOL:DRINI NIKOLLA

# Q.R.M BERAT


SISTEMI KOORDINATAVE SHETERORE



PLANIMETRIA E OBJEKT  
SIP e Ndertimit = 198 m2  
SHKALLA 1:100



ANIMETRIA E OBJEKTIT Nr1 KATI PERDHE  
SIP e Ndertimit = 198 m2  
SHKALLA 1:100



|                                              |            |                  |
|----------------------------------------------|------------|------------------|
| REP.SHOIPERISE<br>MIN. MBROJTJES<br>I.G.J.U. | DREJTORI   | NKOL: ARMAN CANI |
| O. R. M.<br>BERAT                            | VIZATOI    | Ing. A.MURATI    |
| DATA 30/11/2011                              | PERPILOI   | Ing. A.MURATI    |
|                                              | KONTROLLOI | Ing. K. HYSENI   |

ANIMETRIA E OBJEKTIT Nr2 KATI PERDHE  
SIP e Ndertimit = 177m2  
SHKALLA 1:100

